



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.3 , datë 07/05/2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME TË NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “PORSCHE ALBANIA” SH.P.K., ME VENDNDODHJE: AUTOSTRADA TIRANË-DURRËS, KASHAR, BASHKIA TIRANË.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme, të subjektit “Porsche Albania” sh.p.k., me vendndodhje: Autostrada Tiranë-Durrës, Kashar, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor:

- X= 477977

- $Y = 4580301$
- $Z = 56.5 \text{ m}$
- Prurja mesatare : $Q_{\text{mes}} = 0.11 \text{ l/sek}$
- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.1 \text{ l/sek}$
- Qëllimi i përdorimit : Për qëllime të ndryshme (lavazho, sanitare)
- Thellësia e pus-shpimit: 30 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 14 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)
- $X = 477962$; $Y = 4580238$; $Z = 55.5 \text{ m}$
- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.024 \text{ l/sek}$
- Trupi uhor pritës: Impjant trajtimi

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

